

Zv/Drejtor i Përgjithshëm: Martin LEKA

Drejtor i Radios: Alfons ZENELI

*Violina e parë*

Blerta JAKOVA\*  
Spartak SINAMATI  
Edmea KRASNIQI  
Mimoza MUÇO  
Nevila DERGJINI  
Alma SEFERAJ  
Laura AHMATAJ  
Lirza ZALOSHNA  
Joana KAIMI  
Drin KABO  
Edlira SHKURTI  
Lorin LEPURI

*Kontrabas*

Arjan FILJA\*  
Artur STAFASANI  
Rezart DOSTI  
Filid GOLEMI

*Flaut*

Jonela GOLEMI\*  
Rozana KUKA  
Edlira MOSHO

*Fagot*

Pirro SOTA\*  
Lisen MALAJ

*Tromba*

Gazmor HALILAJ\*  
Reinald FOÇI  
Dilaver LELO



*Violina e dytë*

Jadvina VANI\*  
Elda DONO  
Alma SHEHAJ  
Selda PLAVA  
Ehsen ZAJMI  
Anila ÇUNI  
Gerald KOLAGJOKA  
Era CANAJ  
Elona ISLAMAJ

*Viola*

Etleva KATROSHI\*  
Albana KOLA  
Albana MNERI  
Fatmira KOKO  
Agim HASANI  
Greta PRUSHA  
Viola LUCA  
Gilmona BRUZI

*Klarnetë*

Sokol TOTO\*  
Hysen HOTI  
Çlirim BARUNI

*Korno*

Shemsedin VENDRESHA\*  
Arbër NEZIRI  
Briken BURGIIJA  
Denis SHEGAJ

*Trombon*

Ismet KETA\*  
Dorian LLANGA  
Andi KROQI

*Violonçel*

Aristidh PROSI\*  
Gëzim BELEGU  
Andi ALIMEMAJ  
Ardian RESULI  
Florian BINERI  
Evis ZDRULI  
Rajmonda REÇI  
Adriana GRUJA  
Arbias TOÇE

*Obor*

Ermir GRUDA\*  
Nikolin MIRAJ

*S/tuba*

Fatos MULLAHI

*Perkusion*

Gridi KRAJA\*  
Nicolas BONCI

# KONCERT

## Orkestra Simfonike

E RADIO TELEVISIONIT SHQIPTAR



*Dirigjent*

LEONARDO QUADRINI (ITALI)



----- PROGRAMI -----

VALENTIN VEIZI

"The Triumph of Glory" - Poemë Simfonike - (Premierë Botërore)

LUDWIG VAN BEETHOVEN

Koncert No.5, Op. 73 për piano e orkestrë

Soliste: MERITA REXHA TËRSHANA



ALEXANDER SCRIABIN

Simfonia No.2, Op.29 - (Premierë në Shqipëri)

*Drejtor Artistik*

DAVID TUKIÇI

NË SALLËN E UNIVERSITETIT TË ARTEVE

E PREMTE 8 PRILL 2016 ORA 19:00

*Menaxher:* ARMANDO VOLAJ  
*Red. Muzikor:* SOKOL MARSI  
*Kordinator:* AGIM LUBONJA

www.rtsh.al/Radio Tirana/Orkestra  
PRODUCENT 2016

## LEONARDO QUADRINI - DIRIGJENT (ITALI)

Maestro Quadrini është një nga dirigjentët më njohur dhe të suksesshëm në Itali. I diplomuar për dirigjent, kompozicion, muzikë korale, drejtues bande muzikore, piano, organo, aktiviteti i tij është i shtrirë në pesë kontinente dhe kryeqytetet më të mëdha të botës si, Madrid, Helsinki, Paris, New York, Sidnei, Miami, Tiranë, Sofje, Bukuresht, Romë, Minsk, Dubrovnik, Athinë, Seul, Shkup, Caracas, Venecia, Milano, Torino etj, duke dirigjuar orkestra si; Orkestra Simfonike ICO e Provincës së Barit në Itali, Orkestra Oda Teatro "La Fenice" në Itali, Orkestra Simfonike e Umbria Itali, Filarmonia Plovdiv Bullgari, Euroasian Philharmonic Orchestra Korea e Jugut, Orkestra Filarmonike Kombëtare e Venezuelës, Orkestra dhe Kori i Filarmonisë Kombëtare të Moldavisë, Orkestra e Teatrit të Operas e Kosice Sllovakia, Orkestra Filarmonike e Timisoara Rumani, Orkestra e Operas e Odessa Ukrainë, Orkestra e Radio Televizionit Shqiptar, Orkestra Filarmonike e Samara Rusi, etj. Disa nga koncertet më të suksesshme të tij janë; koncert në teatrin Carlo Felice në Genova për zgjedhjen e Kardinalit Bagnasco - Sekretari i Shtetit të Vatikanit, me orkestrën e "Archi della Scala" të Milanos, koncert në Eurovizion për Lumturimin e Nënë Terezës së Kalkutës nga Katedralja e Tiranës në Shqipëri - 2003, Sydney Opera House, me rastin e Ditës së Republikës të Ambasadës Italiane në Australi, koncert në bazilikën e Shën Piut X në Lourdes në pelegrinazhin Unitali e Benevento etj. Ka drejtuar disa nga operat më të famshme si; Turandot, Rigoletto, Cavalleria Rusticana, Aida, Trovatore, Toska, Madam Batterfly, Berberi i Seviljes, Edgar, Karmen, Mefistofeli, etj në vende të ndryshme si; Itali, Rusi, Finlandë, Rumani, Angli, Çekosllovakia, Maqedoni, Moldavi, Zvicër, Spanjë, Monaco, Francë, Bullgari, Greqi, Ukrainë, Poloni, Bjellorusi, Vatikan, Amerikë, Islandë, Brooklyn, Australi, Shqipëri, Korea e Jugut, Egjipt, Venezuelë, Florida, Kroaci etj. Ka bashkëpunuar me shumë artistë të famshëm si; Katia Ricciarelli, Ines Salazar, Nicola Martinucci, Cecilia Gasdia, Chiara Taigi, Maria Dragoni, Giorgio Merighi, Gianluca Terranova, Fiorenza Cossotto, Oscar Ghiglia, Lya De Barberiis, Domenico Nordio, Lucio Dalla, Antonella Ruggiero, Ivana Spagna, Linda, RON, Mariella Nava, Sergio Cammariere, Stelvio Cipriani, Annalisa Minetti, Nair, Grace Michael, Gianni Fiorellino, Enzo Gragnaniello, Linda, Silvia Mezzanotte etj.

## MERITA REXHA TËRSHANA- PIANISTE

Ka mbaruar studimet në Akademinë e Arteve në Tiranë dhe më pas ka ndjekur disa kurse specializimi në Gjermani. Është fituese e disa çmimeve, ka luajtur si soliste në shumë skena dhe festivale të rëndësishme në Shqipëri, Gjermani, Austri, Zvicër, Danimarkë, Itali, Kosovë, Maqedoni, Turqi, Greqi. Me orkestrën e RTSH bashkëpunimi i parë ka qenë në vitin 1998 me koncertin nr.4 të Beethoven-it, më pas me Chopin në 1999, Liszt Totentanz në 2011. Ky është bashkëpunimi i dytë me dirigjentin Leonardo Quadrini pas Brahms, koncertit për piano Nr.2 në vitin 2004. Është pedagoge e pianos në Universitetin e Arteve. Ka titullin Prof. Asoc. që nga viti 2007.



## VALENTIN VEIZI - KOMPOZITOR

Ka mbaruar studimet e larta pranë Akademisë së Arteve Tiranë në degën e kompozicionit me pedagog Aleksandër Peçin. Një prej kompozitorëve më të suksesshëm të brezit të tij, disa herë fitues çmimesh kombëtare dhe ndërkombëtare. Merr pjesë aktive pothuajse në të gjitha aktivitetet konkurruese të këngës organizuar nga RTV Shqiptar si: Anketa muzikore, koncertet "Kur vjen Pranvera" apo festivale të ndryshme të këngës.

Gjatë vitit 1996 ai zbulon zërin e Elsa Lilës dhe e tërheq këngëtarën e re nga skena e Festivalit të Fëmijëve për në skenën e madhe të Festivalit Kombëtar. Në "Fest '96" fiton bujshëm vendin e parë me këngën "Pyes Lotin".

Suksesi i duetit Veizi-Lila do të përsëritet një vit më vonë me këngën "Larg Urrejtje" e cila gjithashtu vlerësohet me çmimin e parë në "Fest '97". Ndërkohë krahas këngës, Veizi shkruan suksesshëm edhe në gjini të tjera si muzikë për drama dhe komedi dhe krijime të ndryshme për orkestër simfonike. Më 1999 i jepet qytetaria Amerikane me motivacionin "Alien of Extraordinary Ability" (i huaj me aftësi të jashtëzakonshme), ku ndërkohë jeton me familjen e tij pranë Bostonit. **Poemi simfonik "The Triumph of Glory"** (Triumfi i Lavdisë) i është dedikuar heronjve dhe viktimave që humbën jetën në Boston Marathon bombing me 15 Prill 2013. Vepra shquhet për karakterin e saj epiko dramatik ku nëpërmjet temave të saj pasqyrohet lufta midis jetës dhe vdekjes. Heronjtë e kësaj vepre janë njerëzit e thjeshtë që përpiqen e luftojnë çdo ditë përkrah të mirës dhe kundra së ligës.



## LUDWIG VAN BEETHOVEN (1770-1827)

Kompozitor dhe pianist gjerman. Konsiderohet gjerësisht si kompozitori më i madh që ka jetuar ndonjëherë, duke dominuar një periudhë të historisë muzikore si askush tjetër para dhe pas saj. Një figurë e rëndësishme në tranzicionin në mes të epokave klasike dhe romantike të muzikës dhe artit perëndimor. I lindur në Bon, Beethoven shfaq talentin e tij muzikor në moshë të re nën kujdesin e të atit. Në 1792 u zhvendos në Vjenë dhe filloi studimet me Haydn, ku shumë shpejt fitoi një reputacion si një pianist virtuoz. Në rreth 1800 dëgjimi i tij filloi të përkeqësohej, dhe nga dekadën e fundit të jetës së tij ai ishte pothuajse krejtësisht i shurdhër. Ai jetoi në Vjenë deri në vdekjen e tij. Kompozimet e tij më të njohura përfshijnë 9 simfoni, 5 koncerte për piano, 32 sonata për piano, dhe 16 kuartete për harqe, muzikë dhome, vepra korale, dhe këngë. **Koncerti Nr.5 për piano i Beethoven-it i njohur ndryshe si "Perandori"** është kompozuar në vitin 1811, kur Beethoven ishte 41 vjeç. Është koncerti i fundit i shkruajtur për piano nga ai dhe më i njohuri nga 5 koncertet për Piano. Emri "Perandori" nuk u vu nga Beethoven, por mendohet nga një pianist anglez Cramer, që mendoi se ishte një emër që i shkonte duke parë karakterin madhështor, temat e fuqishme dhe shpirtin heroik që ka koncerti. Në premierë e parë e ka luajtur Carl Czerny, ish nxënës i Beethoven-it, pasi ai vetë ishte tashmë komplet pa dëgjim dhe nuk luante dot më me orkestër. Që nga shfaqja e parë ky koncert zuri një vend të rëndësishëm në repertorin e pianos, ishte koncerti i preferuar i F. Liszt-it, vend që vazhdon e mban dhe sot. **Koncerti ka 3 kohë, I. Allegro, II. Adagio un poco moto, III. Rondo Allegro ma non troppo.**



## ALEXANDER SCRIBIN - KOMPOZITOR, PIANIST RUS (1872-1915)

Mësimet e para i mori për piano, dhe më vonë në vitin 1884 i bashkohet klasës së Nikolay Zverov, ku në të njëjtën kohë studioje edhe Rachmaninov dhe në vitin 1892 mbaron Konservatorin e Moskës. Ai filloi të kompozonte gjatë viteve që ishte student në Konservator duke u frymëzuar kryesisht nga Shopen. Veprat e tij të hershme përfshijnë nocturne, mazurka, prelude dhe Etude për piano. Nga fundi i shekullit, Scriabin filloi të shkruajë vepra orkestrale, duke fituar një reputacion të madh si kompozitor dhe duke u emëruar profesor në Konservatorin e Moskës. Gjatë viteve të jetës së tij ka kompozuar në disa gjini si; Simfoni, Poema Simfonike, vepra instrumentale si dhe disa vepra për piano Fantazi, Sonata, Mazurka, Nokturne, Prelude, Etyde etj.

**Simfonia No.2, Op 29 në C minor u shkruajt në vitin 1901** dhe për herë të parë u luajt në Shën Petersburg nën dirigjimin e Anatol Lyadov më 12 janar 1902. **Simfonia përbëhet nga pesë kohë. I. Andante, II. Allegro, III. Andante, IV. Tempestoso, V. Maestoso**, edhe pse dy të parat dhe dy të fundit janë të lidhura duke ndjekur njëra-tjetrën pa pushim.